



Republika e Kosovës
Republika Kosova/Republic of Kosovo
Akademia e Drejtësisë/Akademija Pravde/Academy of Justice

Raporti Vjetor Financiar

Për vitin e përfunduar me 31 dhjetor 2019

Janar 2020

Protokolli dalës i Organizatës Buxhetore

Protokolli hyrës i Thesarit të Kosovës

Përmbajtja

DEKLARATË E PASQYRAVE FINANCIARE	- 3 -
Pasqyra e pranimeve dhe pagesave në para të gatshme	4
Raporti i ekzekutimit të buxhetit.....	5
Shënimet shpjeguese për pasqyrat financiare	6
Shënimi 1 Politikat kontabël.....	6
Shpalosja e ndarjeve fillestare dhe finale të buxhetit.....	23
Shënimi 2 deri 12 Prezantim i ndryshimeve materiale	25
Shënimi 2 Paga dhe rroga	25
Shënimi 3 Mallra dhe shërbime	26
Shënimi 4 Shpenzime komunale	28
Shënimi 5 Subvencione dhe transfere	28
Shënimi 6 Shpenzime kapitale.....	29
Shënimi 7 Tjera.....	30
Shënimi 11 Grantet e përcaktuara të donatorëve	30
Shënimi 12 Tjera.....	32
Shënimi 13 Pagesa nga palët e treta.....	32
Neni 16 Raport për të arkëtueshmet.....	33
Neni 17 Raport për detyrimet (faturat) e papaguara	34
Neni 18 Detyrimet kontingjente.....	34
Neni 19 Raport për pasurinë jo financiare	34
Neni 20 Raport për avancet e pa arsyetuara.....	36
Neni 21 Raport për të hyrat vetanake të pashpenzuara.....	37
Neni 22 Raport për bilancet e pashpenzuara të Fondit Zhvillimor në Mirëbesim.....	37
Neni 23 Raport për të hyrat e dedikuara	37
Neni 24 Raport për fondet e donatorëve të pashpenzuara	37
Neni 25 Raport për numrin e punëtorëve sipas listës së pagave.....	38
Neni 26 Raport për numrin e të punësuarve jashtë listës së pagave	39
Neni 27 Raport për numrin e të punësuarve me kontrate për shërbime të veçanta	39
Neni 28 Raport për gjendjen/zbatimin e rekomandimeve të Zyrës Kombëtare të Auditimit (ZKA)	39

Neni 12

DEKLARATË E PASQYRAVE FINANCIARE

Për: **AHMET ISMAILI, Drejtor i Përgjithshëm i Thesarit**

Nga: **ENVER FEJZULLAHU, Zyrtar Kryesor Administrativ (ZKA)**

FATON FETOSHI, Zyrtar Kryesor Financiar (ZKF)

Sipas mendimit tonë, pasqyrat financiare të cilat janë të bashkangjitura, përfshirë shënimet për vitin e përfunduar me 31 dhjetor 2019 janë përgatitur sipas Standardeve Ndërkombëtare të Kontabilitetit të Sektorit Publik të vitit 2017 "Raportimi Financiar sipas Kontabilitetit të bazuar në para të gatshme", i përmbushin të gjitha obligimet raportuese që dalin nga Ligji Nr. 03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë, të plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin nr. 03/L-221, Ligjin nr. 04/L-116, Ligjin nr. 04/L-194, Ligjin nr. 05/L-063 dhe Ligjin nr. 05/L-007 dhe janë të bazuara në shënimet financiare të mbajtura në mënyrë të duhur.

Kjo deklaratë jepet në lidhje me prezantimin e Pasqyrave Financiare të organizatës buxhetore për vitin që përfundon më 31 dhjetor 2019 dhe është pjese përbërëse e pasqyrave financiare.

Ne besojmë dhe konfirmojmë, që:

- Nuk ka pasur parregullsi lidhur me udhëheqësin apo me punëtorët, e cila ka mundur të ketë efekt material në pasqyrat financiare.
- Informatat e dhëna dhe të prezantuara në pasqyrat financiare lidhur me burimin e fondeve dhe shpenzimin e tyre të lidhura me Buxhetin e konsoliduar të Kosovës janë të plota dhe të sakta.
- Informatat në lidhje me grumbullimin e të hyrave janë të sakta.
- Nuk ka tjera llogari bankare të Buxhetit të Republikës së Kosovës përveç llogarive bankare të specifikuara në pasqyrat financiare dhe ky specifikim është i plotë dhe i saktë si në datën 31 dhjetor 2019.
- Nuk ka pasur shkelje të kërkesave të autoriteteve rregullatore të cilat kanë mundur të kenë efekt material në pasqyrat financiare.
- Nuk ka ndonjë ankesë (ligjore) në proces e cila mund të ketë efekt material në pasqyrat financiare
- Të gjitha detyrimet, si ato aktuale ashtu edhe kontingjente, dhe të gjitha garancitë që u kemi dhënë palëve të treta janë regjistruar dhe/ose janë shpalosur në mënyrën e duhur.
- Të gjitha huatë e pranuar janë regjistruar dhe/ose janë shpalosur, sipas legjislacionit në fuqi
- Nuk ka pasur asnjë transaksion pas përfundimit të periudhës i cili do të kërkonte korrigjim ose shpalosje në pasqyrat financiare apo në shënimet e tyre.

Sipas mendimit tonë, pasqyrat financiare që janë të bashkangjitura paraqesin një prezantim të vërtetë dhe të paanshëm të financave dhe transaksioneve financiare për vitin e përfunduar me 31 dhjetor 2019 të Akademisë së Drejtësisë.

Data: __/__/____

Datë: __/__/____

Neni 13

Pasqyra e pranimeve dhe pagesave në para të gatshme

Për vitin e përfunduar më 31 dhjetor

		2019	2018	2017
		Llogaria e vetme e Thesarit	Llogaria e vetme e Thesarit	Llogaria e vetme e Thesarit
		BKK	BKK	BKK
	Shënim	'000	'000	'000
BURIMET E FONDEVE -PRANIMET				
		554	575	516
		550		
		13	31	1
Gjithsej		1,117	607	517
SHFRYTEZIMI I FONDEVE - PAGESAT				
		196	185	186
		351	399	311
		9	10	10
		555	593	507
		562	13	10
		1	0	
Gjithsej		1,117	607	517

Shënim: Pagesat nga palët e treta prezantohen në shënimin 13 në përputhje me SNKPS 2017, efektive nga 1 janari 2019.

Neni 14

Raporti i ekzekutimit te buxhetit

Pasqyra e krahasimit të shumave buxhetore dhe aktuale për **Akademinë e Drejtësisë**
Për vitin e përfunduar me 31 dhjetor 2019

		2019				2018	2017
		Realizimi	Buxheti final	Buxheti fillestar	Varianca	Realizimi	Realizimi
		A	B	C	D=B-A	E	F
		€ '000	€ '000	€ '000	%	€ '000	€ '000
Shënime							
HYRJA E PARASË SË GATSHME							
Të hyrat tatimore	8				#DIV/0!		
Të hyrat nga AKP	9	550	550	550	100.00%		
Të hyrat e dedikuara	10				#DIV/0!		
Grantet e përcaktuara të donatorëve	11	15			#DIV/0!	19	16
Tjera	12				#DIV/0!		
Gjithsej Pranimet		565	550	550	#DIV/0!	19	16
DALJA E PARASË SË GATSHME					#DIV/0!		
Paga dhe rroga	2	196	196	265	100.00%	185	186
Mallra dhe shërbime	3	351	389	590	90.22%	399	311
Shpenzime komunale	4	9	11	15	81.15%	10	10
Transfere dhe subvencione	5	-	-	-	#DIV/0!	-	-
Shpenzime kapitale	6	562	563	563	99.78%	13	10
Tjerat	7	1			#DIV/0!		
Gjithsej pagesat		1,117	1,158	1,433	#DIV/0!	607	517

Shënimi 1 Politikat kontabël

Pasqyrat Financiare për vitin e përfunduar me 31 dhjetor 2019 janë përgatitur sipas Standardeve Ndërkombëtare të Kontabilitetit të Sektorit Publik të vitit 2017 “Raportimi Financiar sipas Kontabilitetit të bazuar në para të gatshme”, i përmbushin të gjitha obligimet raportuese që dalin nga Ligji Nr. 03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë, të plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin nr. 03/L-221, Ligjin nr. 04/L-116, Ligjin nr. 04/L-194, Ligjin nr. 05/L-063 dhe Ligjin nr. 05/L-007.

1.1 Informata për organizatën buxhetore (aktivitetet, legjislacioni, etj)

Akademia e Drejtësisë ka përgatitur Pasqyrat Financiare në harmoni me kërkesat e Ligji Nr. 03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë, të plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin nr. 03/L-221, Ligjin nr. 04/L-116, Ligjin nr. 04/L-194, Ligjin nr. 05/L-063 dhe Ligjin nr. 05/L-007.

Sipas LMFP të gjitha transaksionet me fonde brenda Fondit të Konsoliduar të Republikës së Kosovës behën përmes Llogarisë së Vetme të Thesarit.

(OB në vazhdim të tregoj bazën ligjore të formimit dhe funksionimit të institucionit, misionin dhe vizionin.)

Me Ligjin Nr. 05/L -095 për Akademinë e Drejtësisë (AD), Akademia themelohet si institucion publik i pavarur, funksionet kryesore të të cilit janë, hartimi i programit trajnues dhe organizimi i trajnimit për gjyqtarë dhe prokurorë të shtetit, stafin administrativ gjyqësor dhe prokurorial, trajnimin për avokat shtetëror, avokatë dhe profesionet e tjera të lira, zhvillimin e procesit të vlerësimit të nevojave për trajnime, kryen analiza, hulumtime dhe bashkëpunon me institucionet shkencore, kryen veprimtari botuese në përmbushje të mandatit për nevojat e sistemit gjyqësor dhe prokurorial dhe profesioneve të lira, si dhe kryen edhe punë të tjera të përcaktuara me ligj dhe me akte tjera të Akademisë.

AD organizon trajnime me standarde të larta profesionale dhe me metoda efektive në ngritjen e kapaciteteve të sistemit gjyqësor e prokurorial të Kosovës, duke përfshirë edhe fushën e publikimeve dhe hulumtimeve të cilat kanë në fokus mandatin ligjor dhe përfituesit e AD-së.

Organet kryesore të AD-së janë: Këshilli Drejtues, Këshilli Programor dhe Drejtori Ekzekutiv, ku përgjegjësitë e të cilëve janë të përcaktuara me Ligjin për Akademinë e Drejtësisë.

Në kuadër të strukturës së brendshme organizative të AD-së, përveç Këshillit Drejtues si organ udhëheqës dhe Këshillit Programor si organ profesional dhe këshillëdhënës, përfshihet edhe Zyra e Drejtorit të AD-së, Departamenti i Programeve dhe Departamenti për Administratë dhe Financa.

Aktualisht AD, realizon funksionet ligjore në bazë të tri programeve kryesore të cilat operojnë në kuadër të Departamentit të Programit: Programi për Trajnime të Vazhdueshme, Programi për Trajnime Fillestare dhe Programi për Hulumtime dhe Publikime.

Në kuadër të këtyre programeve trajnuese përfshihen të gjitha aktivitetet të cilat janë të përcaktuara me ligj dhe aktet tjera normative, e të cilat paraqesin mandatin e Akademisë.

Misioni

Akademia ofron trajnim cilësor gjyqësor për gjyqtarë, prokurorë dhe staf administrativ gjyqësor dhe prokurorial, si dhe për profesionistë të tjerë në gjyqësor, analiza, hulumtime dhe veprimtari botuese, në përputhje me kornizën ligjore dhe standardet më të mira të njohura ndërkombëtarisht.

Vizioni

Akademia është institucion modern i të mësuarit, i përshtatur ndaj dinamikës së përgjithshme të zhvillimit, kontribues kryesor për një gjyqësor të paanshëm, të pavarur dhe profesional që gëzon besimin e publikut.

Programi i Trajnimit të Vazhdueshëm


Programi i Trajnimit të Vazhdueshëm (PTV) është program trajnues qëllimi kryesor i të cilit është zhvillimi i vazhdueshëm, avancimi i shkathtësive dhe ekspertizës së duhur profesionale dhe interdisiplinare, të gjyqtarëve, prokurorëve dhe stafit administrativ gjyqësor dhe prokurorial.

Termat që trajtohen në kuadër të PTV janë tema të karakterit profesional-ligjor dhe tema të karakterit interdisiplinar. Strukturat e PTV është e përberë nga: lëmia e së drejtës penale, lëmia civile, drejtësia për fëmijë - aspekti civil dhe penal, e drejta ekonomike, e drejta administrative, lëmia për kundërvajtjes, e drejta kushtetuese, trajnimet e Dhomës së posaçme të Gjykatës Supreme, Trajnimet për Konventën Evropiane për të Drejtat e Njeriut - KEDNJ, Kompetenca interdisciplinare si dhe trajnimet për mos diskriminim.

Mënyra e realizimit të trajnimeve në kuadër të Programit të Trajnimit të Vazhdueshëm, ka përfshirë forma të ndryshme si: trajnime, seminare, tryeza të diskutimeve, tryeza pune, trajnime për trajnues, trajnime për mes platformës së mësimi në distance - E- learning, programe shkëmbimi-internship si dhe vizita studimore jashtë vendit.

Mbështetja e partnerëve ndërkombëtarë në programet e Akademisë së Drejtësisë nuk ka munguar edhe gjatë vitit 2019. Një numër i konsiderueshëm i trajnimeve janë realizuar në bashkëpunim me partnerë ndërkombëtarë duke kombinuar kështu ekspertize vendore me atë ndërkombëtare me ç ‘rast i kanë bërë edhe me të fuqishme trajnime e realizuar në Programin e Trajnimit të Vazhdueshëm.

Gjatë periudhës raportuese janar-dhjetor 2019, në kuadër të PTV-së janë realizuar 147 aktivitete, numri i përgjithshëm i pjesëmarrësve në aktivitetet trajnuese ishte 2775, prej tyre 1567 kanë qenë gjyqtarë, 425 prokurorë dhe 783 profesionist tjerë.




Grafikoni nr. 1: Nr. i Trajnimeve dhe pjesëmarrësve të realizuar për periudhën janar-dhjetor 2019

Programit për Trajnime të Vazhdueshme në periudhën janar – dhjetor 2019, janë realizuar trajnimet sipas fushave:

- Lëmia penale - 54 aktivitete trajnuese;
- Lëmia civile - 30 aktivitete trajnuese;
- Drejtësia për fëmijë – aspekti penal – 9 aktivitete trajnuese;
- Drejtësia për fëmijë – aspekti civil – 3 aktivitete trajnuese;
- Ekonomike - 8 aktivitete trajnuese;
- Administrative – 12 aktivitete trajnuese;
- Kundërvajtje - 5 aktivitete trajnuese;
- Kushtetuese - 1 aktivitet trajnuese;
- Dhoma e Posaçme e Gjykatës Supreme - 3 aktivitete trajnuese;
- Të drejtat e njeriut - 1
- KEDNJ – 6 aktivitete trajnuese;
- E Drejta e BE - 1 aktivitet trajnuese;
- Trajnime për mosdiskriminim – 2 aktivitete trajnuese;
- Kompetenca interdisiplinare – 11 aktivitete trajnuese;

- Trajnimet për gjyqtarë porotë - 1




Grafikoni nr. 2: Nr. i Trajnimeve të realizuar në PTV sipas fushave për periudhën janar-dhjetor 2019

Trajnimet për menaxhmentin e gjykatave dhe prokurorive

Akademia e Drejtësisë me qëllim të ngritjes së shkathtësive praktike dhe performances së vazhdueshme të menaxherëve të gjykatave dhe prokurorive organizon trajnime edhe për menaxhmentin e gjykatave dhe prokurorive.

Gjatë vitit 2019, Akademia e Drejtësisë ka realizuar trajnim dy ditorë për menaxhmentin e gjykatave me temë “Menaxhimi i Gjykatave” si më poshtë:




Grafikoni nr. 3: Nr. i Trajnimeve për Menaxhmentin e Gjykatave janar-dhjetor 2019

Trajnimet për stafin administrativ gjyqësor dhe prokurorial

Akademia e Drejtësisë organizon aktivitete trajnuese edhe për stafin administrativ gjyqësor dhe prokurorial.

Gjatë periudhës raportuese janar-dhjetor 2019, Akademia e Drejtësisë për këtë kategori përfituese, ka realizuar aktivitetet si më poshtë:

- Sistemi gjyqësor, struktura dhe kompetencat;
- Sistemi prokurorial, struktura dhe kompetencat;
- Menaxhimi i punës në administratën e sistemit gjyqësor;
- Moduli 2: Menaxhimi i punës në administratën e sistemit prokurorial;
- Moduli 3: Shkathtësitë ligjore dhe gjyqësore;
- Moduli 4: Menaxhimi i dosjes dhe lëndës në sistemin gjyqësor dhe prokurorial;
- Zhvillimet kryesore në administratën e sistemit prokurorial;
- Integriteti dhe sjelljet etike;
- Lufta kundër trafikimit me qenie njerëzore;
- Moduli 7: Shkathtësitë e buta;
- Bazat e përkthimit konsektiv (marrja e shënimeve) për përkthyes gjyqësor-Gr.I
- Bazat e përkthimit konsektiv (marrja e shënimeve) për përkthyes gjyqësor-Gr.II



Grafikoni nr. 4: Nr. i Aktiviteteve të realizuar për stafin administrativ gjyqësor dhe prokurorial për periudhën janar- dhjetor 2019


Trajnimet për Trajnues

Akademia e Drejtësisë në Programi për Trajnimin të Trajnuesve organizon kurse të specializuara për trajnuesit e Akademisë me qëllim të ngritjes së kapaciteteve dhe përmirësimit të metodologjisë trajnuese.

Gjatë periudhës janar – dhjetor 2019, janë realizuar 4 trajnime për trajnues:

- Shkrimi dhe Arsytimi ligjor;
- Menaxhim i Gjykatave;
- Titujt juridik për fitimin e pronësisë; sfidat në vërtetimin e titullit juridik;
- Regjimi pasuror i bashkëshortëve: Pronësia e përbashkët dhe kontrata martesore.

Nr. i trajnimeve dhe i pjesëmarrjes në TiT 2019



Grafikoni nr. 6: Nr. i Trajnimeve të TIT të realizuar e për periudhën janar-dhjetor 2019

Programi i Trajnimit Fillestar¹

Në kuadër të mandati të saj AD, organizon trajnimin fillestar për aftësimin e gjyqtarëve dhe prokurorëve të sapo emëruar.

Trajnimi fillestar zgjatë 12 (muaj) dhe është i ndarë në dy pjesë: Pjesa e parë përfshinë trajnimin teorik i kombinuar me shqyrtime të rasteve praktike, simulime dhe pjesa e dytë përmban trajnimin praktik, i shoqëruar edhe me trajnime në institucionet jo gjyqësore që lidhen me punën e gjyqtarit dhe prokurorit.

Sipas programit trajnues të miratuar nga Këshilli Drejtues i Akademisë së Drejtësisë, gjatë trajnimit teorik prokurorët e shtetit të sapoemëruar ndjekin 6 module trajnuese (45 nën module) ndërsa gjyqtarët ndjekin 7 module trajnuese të cilat përbëhen nga gjithsej (50 nën-module). Këto nën module janë të ndara në sesione trajnuese sipas programit të miratuar.

Programi trajnues i gjyqtarëve dhe prokurorëve të sapo emërua përmban edhe realizmin e vizitave/ trajnimeve në institucione jo gjyqësore. Trajnimi praktik në institucionet jo gjyqësore ka për qëllim të ju ofroj njohuri gjyqtarëve/prokurove të shtetit të sapo emëruar me legjislacionin dhe praktikën që zbatojnë institucionet shtetërore gjatë punës së tyre, gjithashtu ju ofrohet njohuri për punën dhe aktivitetet që kryejnë këto institucionet, të ndërlidhura me punën e gjyqtarit dhe prokurorit.

Aktivitetet e realizuara në kuadër të Programit të Trajnimit Fillestar (PTF) gjatë viti 2019

Gjatë vitit 2019, trajnimin fillestar e kanë ndjekur katër gjenerata:

- gjenerata e gjashtë e gjyqtarëve serb, të sapo emëruar;(2018-2019)


¹ Neni 19 Ligjit Nr. 05/L-095 për Akademinë e Drejtësisë

- gjenerata e shtatë e prokurorëve të sapo emëruar;(2018- 2019)
- gjenerata e shtatë e gjyqtarëve të sapo emëruar (2019-2020)
- gjenerata e tetë e prokurorëve të sapo emëruar.(2019-2020)

Trajnimi fillestar për gjyqtarët e sapo emëruar të komunitetit serb (gjenerata e gjashtë)² ka filluar me dt. 13 prill 2018 dhe ka përfunduar me dt. 10 maj 2019. Në periudhën janar – maj janë realizuara 84 ditë trajnim prej tyre 37 ditë trajnim teorik apo 74 sesion trajnuese dhe 47ditë trajnim praktik.

Gjenerata e shtatë e prokurorëve ka filluar trajnimin fillestar me dt.05 mars 2018 dhe kanë përfunduar me dt. 05 prill 2019 dhe kanë ndjekur 21 prokuror. Në periudhën raportuese janë realizuar 65 ditë trajnimi, prej tyre 19 ditë trajnimi teorik apo 10 sesione trajnuese dhe 46 ditë trajnimi praktik.

Trajnimi fillestar për gjyqtarët e sapo emëruar gjenerata e shtatë (2019-2020) kanë filluar me 11 mars 2019 dhe do të përfundoj me dt. 10 prill 2020. Këtë trajnim janë duke e ndjekur 39 gjyqtarë të sapo emëruar ku shtatë (7) prej tyre janë të komunitetit serb. Gjatë periudhës raportuese janë realizuar 185 ditë trajnim, prej tyre kanë realizuar në total 184 ditë trajnim, 76 ditë trajnim teorik apo 152 sesione trajnuese, 96 ditë trajnim praktikë dhe 12 vizita në institucione jo gjyqësore.




² Gjyqtarë serb kanë vazhduar trajnimin edhe gjatë vitit 2019 sepse kanë filluar me vonese me gjeneratën e gjashtë


Numri i gjyqtarëve dhe prokurorëve të sapo emëruar PTF-7 dhe PTF-8



Numri i ditëve të trajnimit për gjyqtarët e sapo emëruar mars-dhjetor 2019



Prokurorët e sapo emëruar gjenerata e tetë (2019-2020) gjatë periudhës raportues kanë realizuar në total 126 ditë trajnimi, 49 ditë trajnim teorik apo 98 sesione trajnuese, 66 ditë trajnim praktik dhe 11 vizita në institucionet jo gjyqësore. Prokurorët e sapo emëruar gjenerata e shtatë pritet të përfundojnë trajnimin në maj të vitit 2020.



Programi për Hulumtime dhe Publikime

Programi për Hulumtime dhe Publikime është pjesë e Departamentit të Programit i cili ka për qëllim zhvillimin e kapaciteteve të gjyqtarëve, prokurorëve si dhe stafit administrativ gjyqësor dhe prokurorial përmes ofrimit të burimeve të nevojshme juridike si dhe zhvillimin e programeve trajnuese të AD-së përmes aktiviteteve kërkimore.

Bazuar në Ligjin për Akademinë e Drejtësisë përmes këtij programi kryen edhe analiza, hulumtime dhe veprimtari botuese për nevojat e sistemit gjyqësor dhe prokurorial.

Aktivitetet në PHP

Gjatë vitit 2019 në kuadër të PHP-së janë zhvilluar aktivitete që kryesisht kanë qenë të orientuara në drejtim të:

- Zbatimit të procesit për vlerësim të nevojave trajnuese dhe përpunimit të dhënave për draftin e Programit Trajnues për vitin 2020;
- Vlerësimi i pjesëmarrjes në trajnime;
- Veprimtarisë botuese;
- Aktiviteteve në dobi të revistës juridike Justicia të gjyqtarëve dhe prokurorëve të sapo emëruar;
- Aktiviteteve në procesin e përmblledhjes dhe publikimit të botimeve ligjore në bashkëpunim me GIZ dhe UNDP si dhe
- Menaxhimit të koleksioneve të bibliotekës dhe abonimit në data baza elektronike.

2.1 Zbatimi i procesit për vlerësim të nevojave trajnuese dhe përpunimit të dhënave për draftin e Programit trajnues

Në kuadër të këtij programi është realizuar procesi për vlerësimin e nevojave trajnuese i cili ka kërkuar angazhim dhe përkushtim gjatë gjithë vitit duke analizuar gjitha burimet e informacionit dhe duke përcjellë zhvillimet e reja në gjyqësor. Në funksion të vlerësimit të nevojave trajnuese në periudhën raportuese janë zhvilluar këto aktivitete:

- Janë mbledhë dhe përpunuar të dhënat nga analiza e formularëve të vlerësimit pas secilit sesion trajnues deri në fund të vitit 2019;
- Janë mbledhë dhe përpunuar të dhënat nga pyetësorët për gjyqtarë dhe prokurorë³
- Janë përfshirë KGJK dhe KPK në proces duke kërkuar propozimet nga këto institucione duke përfshirë edhe institucione tjera të drejtësisë;
- Janë kërkuar dhe marrë për bazë edhe propozimet nga trajnuesit e AD-së;
- Janë analizuar gjitha dokumentet strategjike të cilat përmbajnë rekomandime për gjyqësorin duke përfshirë edhe raportin e BE-së për Kosovën;
- Janë analizuar edhe kërkesat e MSA-së veçanërisht ato që kanë impakt për gjyqësorin e Kosovës;
- Janë shqyrtuar portalet e gjykatave dhe prokurorive duke marrë për bazë edhe raportet e punës së tyre;
- Për çështje krahasimore janë shqyrtuar edhe programet trajnuese të institucioneve trajnuese rajonale si dhe
- Në vazhdimësi është përcjellë agenda legislative në kuvend si dhe mediat dhe portalet të cilat kanë pasur në fokus gjyqësorin e Kosovës.

Konsumimi i këtyre mekanizmave ka rezultuar me përmbylljen e këtij procesi duke i kontribuar përgatitjeve dhe hartimit të Programit për vitin 2020.

2.2 Vlerësimi i pjesëmarrjes në trajnime

Në periudhën raportuese, PHP është angazhuar drejtpërdrejtë në analizën dhe hulumtimin e pjesëmarrjes në trajnime të përfituesve të saj. Në funksion të kësaj, me qëllim të evitimit të mangësive në trajnimet që ofron Akademia e Drejtësisë dhe përmirësimit të cilësisë së trajnimeve, është shpërndarë një pyetësor tek gjyqtarët dhe prokurorët. Përfundimet e nxjerra nga këta Pyetësor kanë rezultuar me nevojën e bashkërendimit të punëve mes KGJK-së, KPK-së dhe AD-së. Kjo analizë bashkë me rekomandimet do të shërbejnë në të ardhmen për të gjetur modalitete më të mira për koordinimin e veprimeve lidhur me nxitjen e pjesëmarrjes në krijimin e programeve trajnuese si dhe organizimin e tyre.

2.3 Veprimtaria botuese

Komponentë e veçantë e këtij programi janë publikimet. Në këtë drejtim PHP për periudhën raportuese është angazhuar në procesin e nxjerrjes dhe shtypjes duke qenë në kontakt dhe monitoruar procesin deri në finalizimin e tyre. Kjo komponentë, veçanërisht publikimet që kanë karakter

³ Akademia përveq formularit në kopje fizike ka krijuar pyetësorin online për gjyqtarë dhe prokurorë, linçet e të cilëve iu kanë dërguar të gjitha gjykatave dhe prokurorive të Kosovës,

udhëzues për gjyqtarët dhe prokurorët është mbështetur edhe nga projektet me donatorë si GIZ dhe UNDP


Gjatë vitit 2019 për nevoja të funksionimit dhe zhvillimit të veprimtarisë së AD-së janë realizuar publikimet si në vijim:

- Plani i punës për vitin 2019 i AD-së
- Raporti vjetor i AD-së për vitin 2018
- Programi i Trajnimit për vitin 2020
- Buletini në baza mujore për vitin 2019

Duke marrë parasysh kërkesat dhe nevojat për zhvillimin e kapaciteteve në gjyqësor Akademia e Drejtësisë në mbështetje të GIZ ka hartuar dhe publikuar katër botime ligjore si në vijim:

- Të Drejtat e Njeriut sipas jurisprudencës së Gjykatës Evropiane për të Drejtat e njeriut – përmbledhje e rasteve
- Udhëzuesi për procedurën administrative
- Hyrje në sistemin Ligjor si dhe
- Fjalorin juridik

Në vazhden e publikimeve, në mbështetje të UNDP-së është hartuar dhe publikuar: *Praktika e Gjykatës së Apelit e fokusuar në lëndët të cilat kthehen në rigjykim.*



Grafikoni nr. 1

Me këto botime të cilat kanë karakter udhëzues, Akademia e Drejtësisë ka dhënë kontributin e saj në plotësimin e punës praktike lidhur me vendimmarrjen, hartimin dhe arsyetimin e vendimeve dhe në lehtësimin e bërjes drejtë të drejtësisë.

Me rastin e publikimit të botimeve të lartpërmendura në periudhën raportuese janë realizuar dy ceremoni publikimi të cilat janë mbështetur nga GIZ dhe UNDP në të cilin kanë marrë pjesë akterët kryesor të sistemit të drejtësisë, gjyqtarë, prokurorë, profesor universitarë si dhe pjesëtarë tjerë nga komuniteti ligjor të cilët kanë qenë përfitues të këtyre botimeve.

Me fillimin e PTF-së për gjyqtarët e sapo emëruar të gjeneratës së VII dhe prokurorët e sapo emëruar të gjeneratës së VIII, PHP është angazhuar drejtpërdrejtë në realizimin dhe monitorimin e botimeve të moduleve trajnuese dhe Programit të PTF-së si në vijim:

- Moduli: Kodi Penal;
- Moduli: Kodi i Procedurës Penale;
- Moduli: Rendi Juridik Kombëtar dhe Ndërkombëtar;
- Moduli: Legjislacioni dhe shkathtësitë plotësuese;
- Moduli: Shkathtësitë personale dhe ndër personale;
- Moduli: E drejta civile administrative dhe ekonomike;
- PTF për Gjyqtarët e sapo emëruar;
- PTF për prokurorët e sapo emëruar.

2.4 Aktiviteteve në dobi të nxjerrjes së revistës juridike “Justicia” të gjyqtarëve dhe prokurorëve të sapo emëruar

Këshilli Drejtues i Akademisë së Drejtësisë me qëllim të publikimit në revistat e Akademisë së Drejtësisë, në maj të vitit 2019 ka miratuar Standardet për publikime në revistat e Akademisë dhe njëkohësisht ka konsoliduar Këshillin e Redaksisë në përbërje prej 6 anëtarëve i cili do të jetë përgjegjës për vlerësimin e punimeve për publikim në revistat e Akademisë së Drejtësisë. Ky organ filloj së vepruari menjëherë duke u fokusuar në përgatitjet për nxjerrjen e revistës “Justicia” për gjyqtarët e gjeneratës së VI dhe prokurorëve të sapo emëruar të gjeneratës së VII të cilët e kanë përfunduar në gjashtëmujorin e parë të këtij viti. Në funksion të përgatitjes së kësaj reviste janë realizuar tri takime të këtij organi në të cilin janë ndarë punimet për vlerësim dhe janë diskutuar çështje në kuadër të kompetencave të këtij organi. Nxjerrja dhe publikimi i kësaj reviste pritet në gjashtëmujorin e parë të vitit 2020.

2.5 Aktivitetet e bibliotekës së AD-së

2.5.1 Menaxhimi i koleksioneve të bibliotekës

Biblioteka e Akademisë shërben si një burim kryesor i materialit hulumtues ligjor në mbështetje të gjyqësorit të Kosovës. Të dy platformat si sistemi KOHA ashtu edhe biblioteka elektronike përmes të cilave operon kjo bibliotekë ishte në funksion të përfituesve. Në funksion të kësaj edhe menaxhimi i koleksioneve të kësaj biblioteke ka qenë prioritet gjatë gjithë kohës. Në këtë drejtim është

përditësuar dhe monitoruar në vazhdimësi qarkullimi i resurseve të saj, është vazhduar me rexhistrimin e materialeve të reja ligjore dhe varësisht prej kërkesave qoftë kopjeve fizike ashtu edhe ato elektronike janë ofruar shërbime për përfituesit e saj.

Përveç botimeve të Akademisë, në periudhën raportuese nga AIRE CENTER, AD ka pranuar si donacion 60 ekzemplarë të librit *Fëmijët dhe Gjykata Evropiane për të Drejtat e Njeriut* të cilin me përjashtim të ekzemplarëve për bibliotekën e Akademisë kopjet tjera janë shpërndarë tek përfituesit e Akademisë. Po ashtu nga CIVIL RIGHTS DEFENDERS, AD ka përfituar 40 ekzemplarë nga *Permbledhje e vendimeve nga Gjykata Evropiane për të Drejtat e Njeriut në lidhje me komunitetin LGBT*.

2.5.2 Aktivitetet për prezantimin e platformës së mësimi në distancë, bibliotekës ligjore elektronike të AD-së

Akademia e Drejtësisë në bashkëpunim me OSBE-në ka realizuar katërmëdhjetë (14) punëtori regjionale me temë: “Prezantimi i platformës së mësimi përmes internetit, bibliotekës ligjore elektronike të AD-së. Qëllimi i këtyre punëtorive ishte njoftimi nga afër me shërbimet e teknologjisë informative që ofron Akademia e Drejtësisë për përfituesit e saj si: web-faqja e AD-së, aplikimi online për trajnime, funksionimi i platformës së mësimi në distancë, kyqja në platformë, aplikimi për kurse trajnuese, ndjekja e trajnimeve përmes platformës, kyqja në bibliotekën elektronike të Akademisë, gjetja e literaturës në këtë bibliotekë, dhe literatura që posedon biblioteka fizike e Akademisë. Me rastin e këtyre punëtorive është demonstruar praktikisht nga pjesëmarrësit qasja në platformat dhe data bazat që ofron Akademia në mënyrë që të ardhmen të jenë shfrytëzues të burimeve dhe materialeve ligjore që ofrojnë këto platforma. Përfitues të këtyre punëtorive ishin gjyqtarë, prokurorë, bashkëpunëtorë profesional, zyrtarë ligjor nga gjitha gjykatat dhe prokurorie e Kosovës.

2.6 Qasja në burime ligjore në data bazat ndërkombëtare

Në periudhën raportuese, AD me qëllim që përfituesve të saj t’iu ofrojë resurse dhe burime ligjore edhe nga rrafshi ndërkombëtarë, ka bërë përpjekje të abonimit në data baza ndërkombëtare duke shterruar gjitha mjetet e nevojshme, qoftë përmes donatorëve e edhe sa i përket kapaciteteve vetanake. Për shkak të kostonë së lartë dhe pamundësisë së donatorëve në këtë drejtim, Akademia e Drejtësisë si rezultat i anëtarësimit në Asociacionin e Bibliotekave elektronike që konzorciumi i EIFL-as i siguron për vendet në tranzicion, ka krijuar qasjen në databazat vijuese të natyrës ligjore dhe të përgjithshme. Qasja në këto databaza ndryshon nga viti në vit. Prandaj gjatë këtij viti kemi qenë të abonuar në këto databaza

- IOPscience
- Autoritetet shkencore të Oksfordit për të drejtën ndërkombëtare Fjalori i Oksfordit për Gjuhë Angleze Online
- Enciklopedia e Max Planck për të Drejtën Publike Ndërkombëtare
- Publikimet Edward Elgar
- Revistat online të Cambridge
- OECD-iLibrary
- eBiblioteka e Fondit Monetar Ndërkombëtar.

Aktivitetet në Departamentin për Administratë dhe Financa

Departamenti i Administratës dhe Financave, brenda kompetencave të veta përfshinë shërbimet e përgjithshme teknike dhe administrative, teknologjinë informative, burimet njerëzore, financat, prokurimin, përkthimin, logjistikën dhe arkivin e AD-së.

Aktivitet kryesorë në kuadër të Departamentit të Administratës dhe Financave, përfshihen në:

Shërbimet e përgjithshme:

